



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 20.10.2020, me fillim në ora 10.00. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Përshëndetje për të gjithë, i nderuar nënkryetar z. **Fatmir Iska**, te nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të mediave dhe të gjithë të pranishmit e tjerë.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë :

REND DITE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Raportit Financiar për periudhën kohore Janar – Shtator 2020,
3. Shqyrtimi i Propozim vendimit për transfere dhe rialokim të mjeteve,
4. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte Celinë, Nagac, Krushë e Madhe,
5. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shpallje me interes të përgjithshëm P-71510057-00817-0 – Rahovec,
6. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shpallje me interes të përgjithshëm P – 71510037-01015-96 – Xërxë,
7. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik – Rahovec,
8. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për lirim nga qiraja të gjithë shfrytëzuesit e pronës se paluajtshme komunale,
9. Informatë nga DKA-ja për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021
10. Të ndryshme.

Kryesuesi – Të nderuar kolegë kuvendarë, a jeni për këtë rend dite. Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës: Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar – A ka dikush diçka rreth procesverbalit.

Fehmi Cena – Përshëndetje për ju dhe gjithë të pranishmit në sallë. Unë kam disa ndërhyrje të vogla në Procesverbal dhe mendoj që janë më shumë gabime teknike, te pika e dytë e rendit të ditës: Shqyrtimi i propozim vendimit për miratimin e buxhetit për vitin 2021, te diskutimi im në faqe 3, rreshti i fundit ku thuhet: duket të ceken rrugët me emër e mbiemër dhe unë besoj që mundemi dhe duhet me qenë mundeni, pasi i jep krejt kuptim ndryshe dhe në faqe 4, rreshti i nëntë, edhe vitin e kaluar pra për këtë vit kemi keq klasifikime të buxhetit d.m.th. shpenzime buxhetore dhe unë mendoj se duhet të thuhet shpenzimet kapitale që ka shpenzime për mallra dhe shërbime, po ashtu edhe një rresht me tej ku thuhet se ka cekur Auditori i Brendshëm mirëpo në fakt unë besoj që kam thënë i jashtëm. Po ashtu diçka tjetër mund të them te grandit pasi kam vërejtur në të gjitha shkrimet e qeverisë e shkruani grandit, e që në fakt duhet të shkruhet granti.

Kryesuesi – Faleminderit shumë z. Cena, nëse nuk ka tjerë të lajmëruar sigurisht se sekretaria i përmirëson këto gabime. Atëherë e qesim në votim pikën e parë të rendit të ditës. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i Raportit Financiar për periudhën kohore janar – shtator 2020.

Afrim Limani – Përsëritet për ju kryesues, nënkryetar, anëtarë të KPF-së dhe gjithë të pranishmit. Kam kënaqësinë që para juve të lexoj raportin financiar 9-mujor të komunës së Rahovecit. Para se me hy në raport desha të ju themi që kemi pasur afatin shumë të shkurtër për përgatitjen e këtij raporti sepse jemi marrë shumë me buxhetin e cili është miratuar nga ana e Kuvendit dhe pas miratimit i kemi disa procedura ku kemi një koordinim dhe bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të them të drejtën kjo na ka marrë kohë dhe na ka shkaktuar më pak telashe dhe këtë e thashë krejt në kuptimin e asaj që kemi pasur vonesë edhe në kohë, e këtë e din edhe kryesuesi pasi kemi shfrytëzuar edhe të drejtën që ditën e fundit dhe kjo krejt kjo e arsyetohet që mund të kemi bërë ndonjë gabim teknik mirëpo prapë themi që nuk e besoj. Raporti financiar 9-mujor përbëhet nga dy pjesë, pra pjesa e të hyrave dhe pjesa e realizimit të buxhetit. Pjesa e realizimit të buxhetit është e ndarë në total sipas kategorive edhe sipas nënkategorive në kode ekonomike. Të hyrat e komunës së Rahovecit për këtë periudhë 9-mujore për kundër asaj që kemi pasur vështirësi të inkasimit e sidomos gjatë muajit mars, prill dhe maj por prapë qëndrojmë mirë dhe mundemi me thanë që deri në këtë periudhë realisht ju kemi afruar periudhës së njëjtë të vitit të kaluar dhe për këtë ju garantoj se edhe këtë vit do të kemi tejkalim të të hyrave sepse trendi i të hyrave ka qenë jashtëzakonisht mirë edhe besoj që do të kemi tejkalim të të hyrave buxhetore. Të hyrat 9-mujore në total janë prej 802,141 euro dhe nëse bëjmë një krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar që është 850,809 atëherë del që kemi një diferencë negative në shumen prej 48,667 euro, do të thotë që këto janë të hyra të rregullta, nëse i marrim edhe të hyrat nga gjobat e gjykatave dhe gjobat e trafikut që realisht në këtë periudhë kemi pasur një inkasim të mirë të gjobave të trafikut në shumen prej 140,000 euro atëherë të hyrat në total për këtë 9-mujor janë 944,257 euro që në total është një ndryshim negativ me periudhën e njëjtë të kaluar prej 50,627 euro. Në faqe 5, kemi krahasimin e të hyrave sipas kategorive ekonomike apo sipas llojit të taksave ku shihet që në shumë kategori dhe kode kemi minus inkasim për shkak të periudhës. Në faqe 6, tatimi në pronë kemi inkasim prej 306,668 euro që realisht është një ndryshim në planifikim prej afërsisht 90,000 euro mirëpo duke pasur parasysh edhe situatën me të cilën kemi kaluar prapë kemi inkasim të mirë dhe shpresoj që deri në fund të vitit edhe në kuadër të tatimit në pronë do të kemi edhe më shumë se sa periudha e njëjtë e vitit të kaluar. Në faqe 7, e kemi të prezantuar të gjithë shpenzimin e buxhetit në kuadër të programeve pra drejtorive sipas kategorive ekonomike, kështu që në total shpenzimi i buxhetit është: duke përfshirë pagat, mallrat dhe shërbimet, komunalit dhe transferet dhe investimet kapitale me shumen prej 10,499,526 euro. Në faqen 8, në këtë tabelore i kemi të prezantuar shpenzimin e buxhetit sipas kategorive dhe të shprehura me përqindje, kështu që në total realizimit të buxhetit në shumën prej 10,499,526 euro është 67,99% që konsideroj që jemi në trend të mirë të realizimit të buxhetit edhe deri në fund të vitit shpresoj që përafërsisht 99% do të del shpenzimi i buxhetit në të gjitha kategoritë. Në faqen 9,10,11,12 kemi të prezantuar shpenzimin e buxhetit në kuadër të mallrave dhe shërbimeve sipas kodeve ekonomike dhe në faqe 12 kemi një rekapitullim të përmbledhjeve të gjitha shpenzimeve sipas kodeve ekonomike dhe konsideroj që deri në këtë periudhë edhe trendi i shpenzimit të kësaj kategorie është i mirë edhe lirisht mund të ju them që deri në këtë periudhë nuk kemi fatura në pritje apo borgje sepse është buxheti është i mjaftueshëm dhe ju rrimë gati me ekzekutimin e të gjitha pagesave në kuadër të mallrave dhe shërbimeve, që është risi që realisht nuk ka ndodhur deri me tani edhe po ashtu në raport me Zyrën Kombëtare të Auditorit qëndrojmë mirë sepse ka qenë edhe një e gjetur në kuadër të Zyrës Kombëtare të Auditorit edhe shpresoj që deri në fund të vitit nuk do të kemi obligime nga kategoria mallra dhe shërbime pra faturat do të jenë të gjitha të ekzekutuara edhe nuk do të kemi obligime financiare në kuadër të kësaj kategorie.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, për sjelljen e raportit financiar 9-mujor, para se me marr fjalën z. Fazliu, unë kam një pyetje, ku në faqen 9, tek shpenzimet për mallra dhe shërbime në kodin 13440, në shërbime të ndryshme kuvendi shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse kemi 6797, pastaj kodin 13440 dhe kodin 14230 shpenzimet për informim publik 21697.

Rasim Fazliu – Përsëritet për ju, nënkryetarin, anëtarët për politikë dhe financa, drejtorët dhe në mënyrë të veçantë e përsëritet zyrtarin për informim Haziz Krasniqi dhe gjithë të pranishmit. E falënderoj drejtorin për paraqitjen e raportit financiar janar – shtator 2020. Fillimisht do të ndalem në faqe 3 që ndoshta ju mirë e keni shkruaj, por unë mendoj që tek të hyrat e planifikuara të realizuara 2020/2019 që keni bërë atëherë meqë këtu shkruan periudha janar – shtator dhe tash planifikimin e keni bërë vjetor 1,156,000, atëherë meqë është janar –shtator atëherë nuk duhet me qenë shuma vjetore por edhe këtu duhet me qenë e njëjta janar – shtator e këtyre muajve sa ka qenë e planifikuar dhe nëse mendoni se duhet me ndryshua atëherë duhet me ndryshua për kuvend. Po ashtu e kemi faqe 6, planifikimi dhe realizimi i tatimit në pronë 2020/2019, ku përqindja e realizimit për vitin 2019 dhe prapë përsëritet përqindja e realizimit për vitin 2019 dhe besoj që njëra është gabim dhe duhet të jetë për vitin 2020 njëra dhe nëse konsideroni që janë lëshim atëherë duhet të përmirësohen për mbledhje të Kuvendit. Nëse flasim për të hyrat e planifikuara dhe të realizuara për vitin 2020 mund të themi se realizimi nuk është i vogël dhe është i mirë duke ditur se ne çfarë gjendje jemi sivjet pasi ka qenë vit pandemie dhe ishin dy muaj që shumë pak ka pas të hyra dhe krahas kësaj është mirë mirëpo në qoftëse e krahasojmë me vitin 2019 atëherë mund të konstatojmë se kemi zvogëlim të të hyrave vetanake në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019. Pastaj faqe 5, krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike 2020/2019, unë thjeshtë desha t'i ngris disa shqetësime si p.sh. krahasim të realizimi i vitit 2019 dhe 2020, pse është ai ndryshim i madh i shifrave më interson me ditë pasi janë pothuajse të njëjtat punë që kryhen vit pas viti p.sh. taksa komunale për leje ndërtim një sqarim, pse në vitin 2019 është vetëm 120 euro kurse tash 30,000, ndoshta me siguri që tash janë paraqit më shumë që kanë marr leje dhe për këtë kërkoj një sqarim se pse është kjo diferencë. Pastaj kështu ngjashëm kemi edhe shumë të tjera p.sh. kodin 50012 taksa për ndërrimin e destinimit të shfrytëzimit të tokës, ku në vitin 2019 ka qenë 10,067 euro kurse në vitin 2020 kemi 933 euro që edhe këtu është një ndryshim. Kemi edhe shumë kode të tjera si kodi 50026 taksa për legalizimin e objekteve ku në vitin 2019 ka qenë zero kurse tash 25,073 euro që sigurisht është mirë dhe kërkoj vetëm si sqarim. Në faqe 6 tatimi në pronë, planifikimi dhe realizimi i tatimit në pronë. Nëse e shohim realizimi i tatimit në pronë për vitin 2020 është për 99,211 euro më pak krahasuar me planifikimin që është bërë për vitin 2020. Ndërsa nëse bëjmë krahasime në realizimin e tatimit në pronë për vitin 2020 kemi për 61,501 euro më pak se në vitin 2019, për shkak se ishim në gjendje pandemie dhe deri në fund të vitit planifikohet të përafrohet sadopak realizimi i tatimit në pronë edhe në këtë vit. Në faqe 7, realizimi i buxhetit i shpenzimeve sipas programeve ose drejtorive, tek subvencionet e kemi shifrën 134,650 euro dhe të planifikuara i kemi pasur 311,000 për subvencione, edhe këtu kërkoj sqarime se pse nuk është realizuar me tepër buxheti tek subvencionet pasi ka mbet gati 2/3 e subvencioneve pa u shpërndarë e sigurisht që do të na jepni sqarime të mëtutjeshme. Pastaj faqe 8, të shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe paraqitja grafike e tyre, unë konsideroj që shpenzimi i buxhetit megjithatë për këto 9 muaj është i vogël dhe i pamjaftueshëm sepse po shihen mjetet kanë qenë të alokuara edhe nuk janë shpenzuar në disa kategori ekonomike si p.sh. në kapitale edhe tek subvencionet që thamë me herët, pra në të gjitha kategoritë shpenzimi i buxhetit nuk është bërë aq sa është deshtë. Në faqe 9, pyeti edhe kryesuesi rreth shpenzimeve të Kuvendit, që sigurisht që do të na jep sqarime edhe rreth tyre.

Florida Bajraktari – E falënderoj drejtorin për paraqitjen e raportit financiar për periudhën janar – shtator 2020. Këtë raport e kam lexua dhe analizua por pa deshtë me përsërit edhe atë që e tha edhe parafolësi, do të ndalem tek disa faqe, si faqja 9 shpenzimet në mallra dhe shërbime sipas programeve tek kodi 13440 shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse, kuvendi komunal ka shpenzuar 6797 euro dhe kërkoj sqarim rreth këtij shpenzimi dhe tek faqja 13 kodi 13480 shpenzimet për anëtarësim ku në vitin 2019 janë shpenzuar 5620 euro ndërsa në vitin 2020 shpenzimet kapin shumën 23,431 euro d.m.th. janë katërfishuar edhe këtu kërkoj sqarim se pse është ky ndryshim kaq i madhe. Pastaj tek faqe 14 tek kodi 14410 vendimet e gjykatave në vitin 2019 kanë qenë 8700 euro kurse për vitin 2020 shpenzimet janë rritë në 20,991 euro, pra për të gjitha këto kode kërkoj sqarim.

Fehmi Cena – Fillimisht edhe unë falënderoj drejtorin e financave për përgatitjen e këtij raporti buxhetor edhe për sqarimet që i dha. Unë kam disa ndërhyrje që do t'i bëj, si në faqe 3, ku pak a shumë disa gjëra u cekën dhe ajo çka bien në sy për neve është tek të hyrat tabela 1 të hyrat e planifikuara dhe të realizuara dhe krahasimi i tyre 2020/2019, ku në raport me planifikimin vjetor po del përqindja 69,34% që do të thotë se

nuk i plotëson kuotat e pritura për këtë 9-mujorë, gjithashtu edhe me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Natyrisht që ne i dimë ato sekuencat që i kemi kaluar edhe si qeveri lokale edhe si shoqëri për këtë vit për shkak të pandemisë që po ashtu është shumë e qartë edhe tek tabela 1.2 ku janë të prezantuara të hyrat e rregullta të planifikuara dhe të realizuara në baza mujore, ku shihet qartë që sidomos muaji prill edhe maj kanë qenë me të dobët që përkon me atë situatë fillimi i pandemisë izolimi total që ishte dhe pastaj shohim këta muajt tjerë, të hyra ka pasur me një rritje të dukshme, edhe pse gjatë kësaj kohe ka qenë pandemia pasi unë besoj që qeveria ka qenë me aktive në këtë drejtim, pasi ne kur e kemi diskutue raportin 3-mojor edhe 6-mujor se komuna megjithatë qeveria duhet të angazhohet që të gjej forma që edhe në këto kushte me arkëtua të hyra në mënyrë që sipas planifikimit të realizohet kuota e plotë, por sidoqoftë puna ka dhënë rezultate por nëse krahasohet periudha 9-mujore e planifikimit dhe realizimit ne përqindje po del 92.5%, pra ne kërkojmë që në të ardhmen të punohet në këtë drejtim që realizimi i të ardhurave të jetë komfor planifikimit sepse ajo e dimë sa është e rëndësishme. Në faqe 4, të hyrat e rregullta edhe gjobat ne gjykata dhe gjobat ne trafik, gjithashtu edhe në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ka më pak realizim i të hyrave, por ajo që po bie në sy është se gjobat e gjykatave është një dallim shumë i madh përderisa gjobat e trafikut po shihet që ka pasur të hyra më tepër dhe nuk e di se çka ka ndodhur me gjykata, që ndoshta është nga mos puna e tyre ose nuk kanë qenë efikase apo diçka tjetër por sidoqoftë dallimi është shumë i madh. Në faqe 5, te tabela 1.5 krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike, edhe te tatimi në pronë po shohim se ka pasur një ngecje në arkëtimin e të hyrave dhe në raport me planifikimin atëherë po del 56.7% që do të thotë se është një përqindje e vogël dhe në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi një ngecje por megjithatë tatimi në pronë është ajo pjesë ose shërbim që ne e vlerësojmë më së shumti performancën e qeverisë komunale dhe aty duhet të ketë kujdes me tepër. Po ashtu kërkoj disa sqarime tek disa kode p.sh. kodi 50013 taksat për certifikatat e lindjes, pasi shohim se planifikimi ka qenë shumë më i madh se sa realizimi pra mbi 72,000 planifikimi kurse vetëm 8000 realizimi për këtë periudhë të kohës që me përqindje i bien 11.32% edhe këtu kërkojmë një sqarim nga drejtori me na dhanë se pse është kjo diskrepancë kaq e madhe, pastaj kodi 50015 taksa certifikatat e vdekjes vetëm 711 ose realizimi 59,25% dhe mua tani po më intereson se a ka pas vdekshmëri më pak në këtë periudhë vjetore në raport me vitin e kaluar, që ndoshta drejtori për financa nuk është në gjendje me u përgjigj për këtë statistike por kisha deshtë që për mbledhje të Kuvendit me pas një informatë prej drejtoreshës së administratës që realisht mundet me ditë edhe për taksat të lindjes që e ceka që ka shumë rënie edhe taksa për certifikata të vdekjes dhe kërkoj që për mbledhjen e ardhshme me na tregua se si ka shkua lindshmëria dhe vdekshmëria dhe a përputhen me këto taksa apo jo. Pastaj kodi 50016 edhe këtu kemi një diskrepancë shumë të madhe si planifikimi 1168 kurse realizimi vetëm për këtë periudhë është mbi 29,000. Pastaj kodi 50020 taksa për pjesëmarrje në tender ku shihet se të hyrat kanë zero kurse planifikimi ka qenë 200 euro, dua të di pse është zero, pastaj kodi 50103 largimi dhe deponimi i automjeteve nuk ka arkëtim të të hyrave dhe bash po më intereson a arkëton diçka komuna nga ky shërbim se këtu është vetëm zero, a fiton vetëm kompania që merret me largimin e atyre automjeteve apo diçka i takon edhe komunës. Pastaj kodi 50405 shfrytëzimi i pronës publike, pra planifikimi ka qenë 13,000 kurse të hyrat 2549 euro që në përqindje i bien 19,6% shfrytëzimi i pronës publike, pse kaq pak ka arkëtua komuna në shfrytëzimin e pronës publike, kurse ne si kuvendarë çdo herë kur ekziston propozimi që të ju jepet qytetareve tanë në shfrytëzim prona publike ne çdo here jemi dakord pikërisht për atë arsye që edhe komuna me pas dobi nga kjo. Po ashtu kodi 50416 të hyrat nga shitja e mbeturinave dhe shihet që deri në këtë periudhë nuk është arkëtuar asgjë, pasi planifikimi ka qenë 32,000. Ne se paku e kemi diskutua në këtë mbledhje deponinë e qytetit të Rahovecit dhe kemi mendua me dhanë me ankande për diçka për mirëmbajtje por sigurisht që edhe komuna do të duhej diçka me përfitua nga kjo, mirëpo deri me tash nuk është punuar asgjë në këtë drejtim dhe kërkojmë sqarim nga drejtori pasi kemi zero të hyra nga ky shërbim. Në faqe 8, shpenzimet sipas kategorive ekonomike, ku shihet qartë se pagat dhe mëditjet, shpenzimet janë në rregull edhe pse ka mbetje edhe aty pasi nuk janë shfrytëzuar në përqindjen e duhur, pasi tek pagat dihet sistemi si është, pastaj tek mallrat dhe shërbimet, edhe drejtori e tha që asnjë obligim nuk do të mbetet deri në fund të vitit pa u paguar, megjithatë për këtë periudhë kohore 9-mujore 52% janë kryer obligimet dhe ka edhe shumë obligime tjera për me u krye, përderisa në raport me planifikimet është përgjysmë, pastaj shpenzimet komunale gjithashtu 50%, subvencionet dhe transferët 42%, shpenzimet kapitale mendoj që megjithatë në

raport me planifikimin qëndrojnë mirë dhe unë uroj që ato të jenë sa me mirë duke ditur se është indikator sa me i rëndësishëm në vlerësimin e performancës komunale.

Rasim Fazliu – Desha t'i them drejtorit se në faqe 5, i ka të përsëritura të hyrat e rregullta si gjobat e gjykatave e të trafikut që po ashtu i ka edhe në faqen 4 këto të dhëna shumë mirë dhe nuk ka nevojë të jenë të shkruara edhe faqen 5 të njëjtat.

Afrim Limani – Faleminderit për pyetjet, kryesisht Kryesuesi i bëri dy pyetje, pasi ishte i interesuar me ditë shpenzimin në kodin 13430 shpenzimet e ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse shuma 6797euro. Sa për informimin tuaj, emërtimet e shume shpenzimeve sipas ligjit në fuqi në kuadër të Ministrisë së Financave këto kode emërtohen kështu, tash realisht kjo shume është krejt shuma e mëditjeve që ju paguajmë anëtareve të komiteteve pra të gjitha komitetet që marrin mëditje paguhen nga ky kodë edhe kjo shume ka arritur këtë vlerë. Pastaj shpenzimet për informim publik me shumën prej 2697 euro, kjo ekskluzivisht është ajo që xhirimet që janë bërë në sallën e kuvendit nga ana e kompanisë kontraktuese që e kemi pasur, pra janë këto shpenzime. Pastaj edhe z. Rasim Fazliu i ka bërë disa pyetje dhe kërkoj falje që nuk kam mundur me i shkrua të gjitha pyetjet që keni parashtrua mirëpo mund të krijojmë hapësirën edhe e bëjmë edhe interaktiv që ndoshta do ta kemi edhe me lehtë Pasi që shumicën e gjerave në raport i kemi përgatit vetë edhe besoj ë mundemi me dhanë përgjigje. Pyetja e parë e mësuesit ishte te planifikimi i buxhetit Janar – Shtator dhe unë dua të them se nuk e kemi marr krahasimin jo në total të buxhetit por për periudhën raportuese, pra planifikimin e kemi marr deri në shtator edhe realizimi figuron deri në shtator, pra në bazë të realizimit kemi shkruar edhe kemi marr si mostër si krahasim periudhën 9-mujore, kurse në fillim e kemi të planifikuar në total. Po ashtu keni pyetur te kategoritë apo llojet e taksave, ku ka dallime në mes të planifikimit dhe realizimit që të gjithë keni bërë këtë pyetje dhe sa për dijeninë e juaj ju informoj se ka pasur një lloje unifikimi të të hyrave ku kanë ndryshua shume kode dhe e kemi krijuar një program të ri që është bërë një dallim i madhe i të hyrave dhe kjo po na krijon huti edhe neve p.sh. në kuadër të administratës që kishte edhe pyetje, që vitin e kaluar çdo drejtori e ka pasur lloje të hyrave në kuadër të administratës dhe në kuadër të shpenzimeve apo të hyrave administrative të gjitha kanë qenë të koncentruar në kuadër të një kodi edhe tash këto janë të ndara edhe secila drejtori e ka pjesën e vet të taksave administrative që e paguajnë ka një euro. Pra këtu është dallimi edhe ka mospërputhje në raport me planifikim dhe realizim të buxhetit. Po ashtu ishte një pyetje rreth taksës komunale për leje ndërtimi, pasi 3 vite radhazi është parashtrua nga ana e juaj edhe që ka tingëlluar shumë e palogjikshme pasi taksa komunale nga leje ndërtimi është regjistruar në inspektimi i planit urbanistik d.m.th. në përmes Ministrisë dhe IT-së e kemi rregulluar përfundimisht edhe tash taksa komunale për leje ndërtimi regjistrohet saktë në kuadër të këtij kodi, pasi deri në këtë periudhë e kemi planifikua 17,700 dhe realizimin e kemi 30,000 edhe këtu e kam një përgjigje se pse realizimi është më i madh se sa përqindja edhe tek inspektimi i planit urbanistik kemi një shumë prej 3982 euro që realisht edhe kjo shume duhet me kaluar në kuadër të taksës komunale për leje ndërtimi mirëpo në fillim të vitit zyrtaret që inkasojnë këto të hyra kanë gabua edhe janë regjistruar dhe në momentin që kemi vërejt këtë gabim atëherë kemi intervenua dhe menjëherë pas muajin Janar shkurt të gjitha të hyrat realizohen në kuadër të këtij kodi. Mirëpo ndodh nganjëherë që planifikimi është me i vogël se sa realizimi edhe në fillim e kam thënë në momentin që e kam prezentua buxhetin, në komuna e Rahovecit në krahasim me komuna tjera vazhdimisht kemi bërë kërkesë në Ministrinë e Financave kur bëhet hartimi i buxhetit që neve me na u rritë të hyrat vetanake, pasi çdo komunë e republikës së Kosovës kërkon me i zbritë kurse në po kërkojmë me i rritë sepse jemi të sigurtë sa mundemi me arritë edhe kjo u dëshmuar pasi kemi pasur edhe vitin e kaluar edhe vite tjera tejkalim të hyrave prej 170,000 euro. Tash derisa ata nuk na qesin limitin e caktuar ose të hyrat limitet ose tavanet buxhetore për të hyrat vetanake atëherë ne duhet me bo planifikimin në kuadër të atij limiti që realisht po i bien që na pa vullnetin tonë dhe jemi shume të sigurtë po jemi nën planifikimin real, pasi e kemi një shume fikse edhe ne po duhet me zbritë dhe po jemi shume të vetëdijshëm se është planifikim joreal që ne mundemi me arrit më shumë edhe këtu ka mospërputhje me planifikim dhe realizim të buxhetit. Pyetje tjetër ishte tek subvencionet, vërtet që deri në atë periudhë nuk ka pasur realizim të mirë të buxhetit në disa kategori p.sh. subvencione, mallra dhe shërbime dhe komunali, edhe përkundrazi investimet kapitale siç e tha edhe doktori edhe në total buxheti ka qenë mirë mirëpo mund të themi që deri në këtë fazë realizimi i buxhetit deri në ditën e sotme në total është prej 72% që realisht i bien edhe 3% edhe ne me arritë limitin.

Mirëpo realisht ju thash edhe ne fillim edhe ju garantoj se për këtë vite financiar fiskal realizimi i buxhetit do të jetë 99% duke ditur krahasimin edhe trendin e shpenzimit të buxhetit që jemi duke bërë. Po ashtu edhe pyetja e parashtruar nga Florida Bajraktari është e njëjta përgjigje sikur për Kryesuesin, te vendimet gjyqësore përkundër asaj qëndrojmë mirë pasi kam pritur që situata nuk do të jetë mirë, pasi ky shpenzim lidhet kryesisht me një operator i cili faturat e veta i ka dërgua ne thesar dhe ne jemi detyruar që përmes vendimit të gjykatave, e që ne fakt është edhe një shpenzim i vogël për pagat jubilarë për mësuesit që janë dal ne pension pasi na kanë paditë dhe jemi detyruar me bo dhe pas muajit mars nuk kemi probleme të tilla dhe besoj që nuk do të kemi deri ne fund të vitit fiskal dhe kjo shume që është aty do të jetë fikse edhe nuk ndryshon më. Rreth pyetjeve të parashtruara nga doktori, nuk kam mundur të gjitha pyetjet me i shkrua mirëpo mund ta bëjmë në mënyrë interaktive, tek të hyrat që e dhashë edhe një sqarim me herët tek të hyrat, që e potencova shitja nga të hyrat nga mbeturinat që ne jemi detyruar sipas direktivave të Ministrisë së Financave që me bo një planifikim dhe kësaj here e kemi bërë planifikimin më të vogël mirëpo prapë deri në këtë fazë nuk ka ndonjë lëvizje sepse inkasimi i të hyrave edhe pse ata e qesin me shpresë se do të kemi inkasim të të hyrave nga mbeturinat, por realisht nuk ka asnjë lëvizje deri më tash sepse duhet me qenë një udhëzim administrativ ose një pako ligjore pastaj shtimi i stafit e shumë probleme tjera mirëpo deri me tani nuk kemi ndonjë lëvizje edhe ky planifikim mbetet ashtu. Tek shfrytëzimi i pronës publike, realisht në kontratat që i kemi nënshkruar me fermerë, shuma totale në bazë të kontratës që ekziston është 13,000 d.m.th. fermerët të cilët i kanë marr parcelat bujqësore në shfrytëzim dhe nuk janë paguar deri me tash edhe shpresoj që deri në fund të vitit do ta bëj inkasimin total të vlerës së borxhit që ata e kanë edhe kjo sigurisht që do të rritet më shumë, pasi një pjesë e vogël e ka paguar edhe shpresojmë që edhe për këta dy muaj të mbetur me krye obligimin total këta fermerë edhe planifikimi me dal real. Te taksa për certifikata, realisht këtu kemi një problem pasi janë përzije kodet dhe kam biseduar me shefin e IT-së sepse ai duhet me u inkadruar aty edhe me bo një koordinim me zyrtarin që lëshon certifikata edhe zyrtarin të hyrave. Pra këtu është një gabim teknik që realisht po na përcillet që një kohë të gjatë dhe shpresojmë që të eliminohet sa me shpejt edhe kjo e hyrë të shkojë ne kodin e duhur. Realisht me shefin e administratës jam në kontakt të vazhdueshëm pasi ka mospërputhje me atë çka po ndodhë dhe ajo që po regjistrohet, edhe pse kemi probleme siç e thash edhe ne fillim, mirëpo shefi i administratës i ka shënimet e sakta të lindshmërisë dhe vdekshmërisë edhe çdo raport e ka në baza javore dhe sigurisht që atë raport ne mbledhje te kuvendit do ta kenë. Pastaj rreth shpenzimit të buxhetit ka shkua shume mirë deri ne këtë periudhë siç e thash edhe ne fillim përqindja e realizimit të buxhetit është 72%, edhe një informatë për fund jemi me datën 20 tetor kështu që kemi edhe dy muaj në dispozicion dhe trendi i të hyrave vetanake po shkon mirë kështu që kanë mbetur edhe 140,000 euro pa e plotësua planifikimin, kështu që jam shumë i sigurt që edhe këtë vit kemi me pas tejkalim të realizimit të hyrave dhe atë në mënyrë të theksuar.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për sqarimet, të nderuar kolegë, kalojmë ne pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Propozim vendimit për transfere dhe rialokim të mjeteve.

Afrim Limani – Kjo pikë është ridestinimi i mjeteve financiare apo teprica e mjeteve financiare nga programet e ndryshme, që realisht ende nuk kemi ndonjë dokument apo thirrje nga Ministria e Financave, mirëpo ne si drejtori e Financave e kemi përgatit këtë dokumente në mënyrë që të jemi gati, pasi ne bazë të traditës se kaluar Ministria e Financave jep afat 2 apo 3 ditë në mënyrë që organizatat buxhetore që realisht e ka prapavijën e vet që mos të këto procese dhe këto mjete të mbesin suficit dhe ne për mos me thirr një seancë të jashtëzakonshme atëherë këtë pikë të rendit të ditës e kemi qitë në mënyrë të rregullt në Kuvend dhe nëse eventualisht mes këtyre datave e kemi ndonjë thirrje atëherë duhet me bo një seancë të jashtëzakonshme mirëpo nuk besoj edhe shpresoj që brenda afatit të rregullt kohor e kryejmë këtë pikë edhe atëherë vetëm e presim njoftimin nga Ministria e Financave se ka ridestinim të mjeteve. Shuma e mjeteve të cilën e kanë paraparë disa drejtori që me një formë apo formën tjetër nuk mund të realizojnë këtë pjesën tjetër të buxhetit ne total është 192,000 euro që është pjese e mjeteve financiare nga dy burime si nga granti i përgjithshëm edhe nga të hyrat vetanake. Pra e gjithë shuma nuk është vetëm nga granti por edhe një pjesë është nga të hyrat vetanake sepse edhe nëse nuk ka ridestinim te mjeteve ne nuk do të rrezikohemi nga pjesa e të hyrave vetanake që buxheti të shkon në suficit. Janë kryesisht 4 apo 5 drejtori që kanë tepricë të mjeteve si administrata, drejtorja e zhvillimit ekonomik, drejtorja e shëndetësisë, drejtorja e bujqësisë dhe drejtorja

për kulturë rini dhe sport që i ka disa projekte të cilat i ka paraparë për ridestininim. Pra, shuma totale është 192,000 euro që duhet të ridestinohej.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, të them të drejtën si shpesh po ndodh riallokimi i mjeteve në komunën tonë. Unë do ti thoja drejtorit se kjo më tepër është pasojë e keq planifikimit të buxhetit për vitin 2020, mirëpo ne gjithsesi që do ta mbështesim dhe nuk jemi që këto mjete të shkojnë në suficite dhe propozoj që herëve tjera të bëhet planifikimi me i mirë, pasi kemi kode që janë të parapara dhe nuk është punuar asgjë dhe disa kode tjera si p.sh. E-kioskun e kemi ditë që është funksional atëherë pse janë paraparë mjete këtu. Por unë me tepër do ta quaja këtë si keq planifikim dhe për këtë arsye ka ardhur deri te kjo pasi keni paraparë kode edhe nuk janë shfrytëzua disa projekte dhe ka ardhur deri te teprica e mjeteve por gjithsesi jam që me përcjell për kuvend që mos me i lanë mjetet me shkua ne suficite dhe i vendosim aty ku janë paraparë për ridestininim të mjeteve.

Fahrie Lushi – Faleminderit kryesues, paraprakisht i përmendi pasojat e keq klasifikimit edhe parafolësi, edhe gjatë dëgjimeve publike kemi pasur një seancë të jashtëzakonshme për ridestininim të mjeteve, kështu që ndoshta nuk është diçka e jashtëzakonshme që mos me përcjell edhe mos me i dërgua këto mjete dhe me përkrah bartjen e këtyre mjeteve mirëpo ne disa kode mendoj që ndoshta me mirë do të ishte të kanë rotacion këto kode se sa të kalohen prej një kodi ne kodin tjetër por megjithatë ne e përkrahim edhe e përcjellim tutje këtë për bartjen e mjeteve.

Kryesuesi – Faleminderit zonja Lushi, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatojmë se kalon për kuvend pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte Celinë, Nagac, Krushë e Madhe.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, te nderuar drejtorë, anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa. Sipas të ligjeve ne fuqi, para jush keni propozimin e Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore. Bëhet fjalë për 5 parcela, për parcelën 231-0 që është në zonën kadastrale në Celinë, pastaj 809-0 në zonën kadastrale në Nagac, pastaj 258 në zonën kadastrale në Krushë e Madhe, 257 në Krushë të Madhe si dhe 256-0 Krushë e Madhe. Të gjitha këto parcela janë pronë shtetërore të Kosovës KK. Rahovec përveç një gabimi teknik që na ka rrjedh ne pikën 1.1 që bëhet fjalë për 4 hektar e jo për 6 hektar d.m.th. parcela 231-0 që është me sipërfaqe prej 35 hektar e 62 ari e 63m² dhe ne prej kësaj sipërfaqe kemi ndaje pjese të parcelës me sipërfaqe prej 4 hektar. Po ashtu vlen të ceket që pas shqyrtimit dhe miratimit të këtij propozimi kërkojmë prej jush që kur të nxirret vendimi në Kuvend, të nxirret vendim për secilën parcelë veç e veç. Pra nuk kemi deshtë me ngarkua rendin e ditës me 5 pika tjera por kur të nxirret vendimi në Kuvend që të na jepet e drejta që të nxjerrim vendim për secilën parcelë veç e veç që këshillat e fshatrave të kenë ne vendime dhe lokacione të sakta se ku gjenden këto. Ftojë anëtarët e KPF-së që pas shqyrtimit, të votojnë propozim vendimin.

Dervish Çadraku – Unë kam pyetje për drejtorin që para disa kohe kemi biseduar edhe pika tjera të grumbullimit të mbeturinave dhe po më intereson se si qëndron puna me pjesën prej Gradishit deri në Kramovik, se a është caktuar ndonjë lokalitet apo ende është në procedurë për me gjetë vendin pasi vërtet ka nevojë dhe është territor me një hapësirë të madhe.

Rasim Fazliu - Faleminderit kryesues, e falënderoj drejtorin për këtë prezantim për caktimin e lokacioneve për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte. Unë i propozoj drejtorit që çdo herë edhe ne mbledhje të KPF-së por edhe të Kuvendit mundësisht nëse i kemi aparaturat që me na prezantua gjithmonë përmes video projektorit terrenin ekzakt me projekt që me na tregua në detaje që sigurisht do të ishte me efikase edhe me mirë e jo kështu sikur tani pasi shumë anëtarë të Kuvendit Komunal ndoshta nuk i din të gjitha lokacionet, kështu që herëve tjera të mundësohet prezantimi përmes video projektorit.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, ne bashkërisht me drejtorët e drejtorive kompetente për këtë fushë dhe me kryesitë e fshatrave i kemi vizitua lokacionet por fatkeqësisht ende nuk kemi gjetur lokacion që është në pronë shtetërore në fshatin Malësi e Vogël, pasi ne kemi biseduar me kryetarin e fshatit atje dhe i kemi kontrollua disa parcela edhe na ka figurua prona private edhe disa te privatizuara edhe i kemi pezullua për

muaj të tjerë edhe besojmë që kurdo që gjendet lokacioni edhe i përcjellim. Sa i përket pyetjes se drejtë të z. Fazliu për shkak të kohës nuk kemi deshtë me ju ngarkua përndryshe për kuvend do të i përmirësojmë.

Kryesuesi – Faleminderit shume drejtor për sqarimin, atëherë kolegë të nderuar meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar rreth pikës se katër, konstatojmë se kalon për kuvend. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shpalljen me interes të përgjithshëm P-71510057-00817-0-Rahovec.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, para jush keni propozim vendimin e kryetarit të komunës për shpalljen me interes të përgjithshëm të parcelës P- 00817-0 në Rahovec, që bëhet fjalë për pronë shtetërore të Kosovës, që shfrytëzues është Kosova Petrol me sipërfaqe prej 6 ari 91m². Qëllimi i shpalljes së kësaj parcele me interes të përgjithshëm është për faktin se tani jemi në përfundimin e procedurës për projektimin e sheshit qendror të qytetit. Ftoj anëtarët e KPF-së të votojnë propozim vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm.

Fehmi Cena – Ne tash e kemi të njohur projektin e sheshit qendror pasi ka qenë në diskutim edhe më përpara në Kuvend dhe e kemi përkrah plotësisht, gjithashtu disa prona që kanë qenë në shfrytëzim i kemi përkrah me herët që të bëhet shpallja e interesit të përgjithshëm, por me çuditë fakti se si ka mbetur edhe kjo pjesa pronë publike, që edhe atëherë kur i kemi shqyrtuar ato pronat dhe është kërkuar nga ne pëlqimi për shpallje me interes të përgjithshëm, sigurisht se qysh atëherë e kishim krye punën apo shtrohet pyetja se mos ka edhe ndonjë pjesë tjetër e cila ka mbetur aty dhe ndoshta përreth asaj pjese që mendohet me u bë sheshe, nëse ka nevojë atëherë le të kryhen të gjitha pronat që ne me bashkëngjitë pëlqimit për këtë interes të përgjithshëm dhe natyrisht që jemi që nëse është vërtet pronë komunale atëherë le të hyjë në kuadër të interesit të përgjithshëm dhe në kuadër të sheshit dhe pastaj sigurisht që kur të bëhet plani i sheshit ne duhet të jemi të njoftuar se çka do të bëhet me secilën pjese aty.

Rasim Fazliu – Unë vetëm desha me u lidhë njëjtë me pikën e mëparshme, së a është prapa pompës se shtetit ai terrene aty, kështu që siç e thash edhe me herët që është mirë me na sqarua do të ishte më mirë pasi nuk e dimë saktësisht, që sigurisht që drejtori na tregon edhe për mbledhje të kuvendit propozoj që përmes projektorit me na tregua.

Afrim Oruqi – Sa i përket pyetjes se kuvendarit Fehmi Cena, ne e kemi ditur saktësisht edhe ne fillim kur kemi ideu me projektua sheshin qendror mirëpo për shkak se udhëzimet administrative edhe ligji për këmbimin e pronave edhe shpronësimit kanë ndryshua, ne tash po fillojmë dhe kjo është veç faza e parë dhe do të provojmë me ble këtë pjesë sepse menaxhohet prej Kosova Petrolit d.m.th. po provojmë me hije me ble këtë parcelë me 20% sipas ligjeve që janë të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Sa i përket pyetjes se drejtuar nga z. Fazliu, kjo është saktësisht ku është Kosova Petrol, pompa e Kosova petrolit me zyre administrative dhe me një oborr të vogël që krejt këto bëjnë 6 ari 91 m².

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për sqarimet, meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar për diskutim, konstatoj se kalon për kuvend pika e pestë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shpallje me interes të përgjithshëm P-71510037-01015-96- Xërxë.

Afrim Oruqi – Bëhet fjalë për shpalljen me interes të përgjithshëm të parcelës 01015-96 në zonën kadastrale në Xërxë. Qëllimi i shpalljes së kësaj sipërfaqe me gjerësi prej 87m² në pjesë të përgjithshme është sepse kemi hyrë në fazë që të i vazhdojmë në seanca tjera nëse ju na përkrahni, për shkak se aty ne mandatin e kaluar është hapur një rrugë që tash veçse është e kaluar në Xërxë që është rrugë publike dhe ne po provojmë me rregullua këtë problematikë, që pas shpalljes së këtij interesi të përgjithshëm të provojë të rirregulloj megja atje aq sa kemi marr për rrugë ne pronë private dhe të japim pronë shtetërore dhe të kryhet ky projekt që të mos kemi telashe tjera në të ardhmen nëpërmjet organeve gjyqësore. Pra qëllimi është hapja e rrugës publike edhe pse ne terenë ruga është e kalueshme dhe e kubëzuar në mandatin e kaluar dhe krejt çfarë po bëjmë ne tani që ti rirregullojmë këto megja sipas ligjeve në fuqi. Kërkoj prej kuvendarëve që të votojnë propozim vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm.

Dervish Çadraku – Prapë është njëta pyetje se ku gjendet ky vend pasi vërtet nuk jemi ne dijeni se ku gjendet saktësisht nëse nuk e shohim me video projektor.

Rasim Fazliu – Unë vetëm desha me bo pyetje se a ka bërë kërkesë dikush prej personave të caktuar aty që me rregullua këtë çështje, sigurisht se persona fizik e shfrytëzojnë atë rrugë dikush e që tash me kompensua me pronë shoqërore, pasi këtu nuk pash që kishte ndonjë kërkesë nga dikush rreth kësaj apo është vetiniciative e komunës që me zgjidh çështje pa kërkesë të ndokujt.

Afrim Oruqi – Sa i përket kërkesave të njëjta, do të kujdesemi që edhe herëve tjera mos të ndodhin gabime teknike dhe ti prezantojmë ne projektor. Sa i përket pyetjes se a kishte kërkesë, në fakt ka pasur kërkesë prej palës fizike të përfaqësuar prej një avokati publik në komunën e Rahovecit. Pala pra parcela kufizohet me pronë shtetërore për shkak të rrëzës se rrugës që është deshtë patjetër me përfshije dhe kthesës se rrugës ka marr edhe pronë private dhe ne po kërkojmë që ai është në kufij me pronë shtetërore dhe veç të rirregullojmë këtë problematike nëpërmjet këmbimit në faza tjera nëse ju na përkrahni.

Kryesuesi – Faleminderit shumë drejtor për sqarimet, atëherë të nderuar kolegë, meqë nuk ka tjerë të lajmëruar për këtë pikë, konstatojmë se kalon për Kuvend edhe pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik –Rahovec.

Artan Asllani – Përshëndetje kryesues, nënkryetar, anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, kolegë drejtor dhe gjithë ju të pranishëm. Propozoj Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin e Komunës së Rahovecit miratimin paraprak për vendimin për dhënien e pronës se paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik dhe zhvillimin e procedurave për ankand publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër prej 5 viteve. Prona e paluajtshme lokalet afariste për dhënien në shfrytëzim të cekur në pikën 1 të këtij propozimi gjendet ne zonën kadastrale ne Rahovec konkretisht te Palestra e Sporteve „Mizahir Isma,, në Rahovec. Në këtë hapësirë gjenden 10 lokale afariste, lokali nr 1 ne sipërfaqe prej 56.62m2, lokali me nr 2 dhe nr 3 me sipërfaqe prej 61,36m2, lokali me nr.4,5,6,7,8,9 me sipërfaqe 56,45m2 dhe lokali me nr.10 me sipërfaqe 53,05m2. Qëllimi i dhënies ne shfrytëzim të pronës se paluajtshme për lokalet afariste komunale është edhe interes i joni për shkak se bëhet ruajtja dhe rritet vlere e pronës komunale. Procedura për dhënien e pronës se paluajtshme në pronësi të komunës në shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmes ankandit publik. Ftoj të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa të përkrahin këtë pikë të propozimit.

Rasim Fazliu – E falënderoj drejtorin për këtë prezantim dhe desha me pyet drejtorin se pse na ka thënë 5 vite, pasi nëse i nënshtrohet ankandit atëherë ne jemi Kuvendi edhe ne e caktojmë afatin se sa do ta japim. Kështu që drejtori mundet me thanë se i nënshtrohet ankandit publik e pastaj që afatin se sa do jepet në shfrytëzim e cakton Kuvendi ne bazë të dakordimit që bëjmë këtu si Kuvend bashkë me juve gjithsesi. Kështu që për Kuvend është mirë me rregullua në atë mënyrë që jepet sipas ankandit mirëpo pastaj Kuvendi merr vendim, pasi kështu si thuhet tani po e merr si formën e prerë 5 vite edhe ne si kuvendarë duhet të pajtohemi me këtë.

Fehmi Cena – Kur jemi te dhënia e pronës se paluajtshme komunale në shfrytëzim për personat fizik dhe juridik, unë mendoj se natyrisht si deri me tani çdo herë e kemi dhënë pëlqimin edhe sigurisht se jam edhe për këtë, në mënyrë që ato lokale që janë aty të jepen në shfrytëzim pasi është dobi e dyanshme edhe e komunës edhe e qytetarëve tanë që ato të shfrytëzohen. Gjithashtu edhe unë kam vërejtjen time rreth afatizimit për 5 vite. Mendoj se duhet ta diskutojmë në asamble komunale pasi duhet të shihet se cila periudhë është më joshëse për qytetarët afaristë që mendojnë me i marr ato lokale, pasi për 5 vite mendoj se është periudhë e shkurtër pasi më joshëse kish me qenë në periudhë me afatgjate, por sidoqoftë në asamble komunale vet lejohet ajo hapësira që me qenë deri në 15 vite, që të japin edhe kuvendarët e tjerë që janë ekonomistë e juristë e të tjerë.

Kryesuesi – Faleminderit z. Cena, po mendoj që me fillua me 5 vite dhe në momentin e skadimit të kontratës me ju vazhdua për 10 vite. Atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatojmë se kalon për Kuvend edhe pika e shtatë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për lirim nga qiraja të gjithë shfrytëzuesit e pronës se paluajtshme komunale.

Artan Asllani – Po ashtu për këtë pikë kemi planifikuar të bëjmë një propozim për lirim për të gjitha objektet dhe lokalet afariste komunale të cilat realisht kanë kontratë me komunën e Rahovecit, mirëpo për

shkak se gjendemi me një vit jashtëzakonisht të vështirë sidomos për bizneset. Ne edhe me herët e kemi bërë lirimin me vendim të kuvendit për periudhën mars, prill dhe maj nga kjo kategori për 3 muaj dhe po ashtu kemi propozuar edhe për periudhën tetor, nëntor dhe dhjetor të këtij viti të bëhet edhe lrimi nga obligimi për 30 lokale afariste komunale. Në pikën 3 obligohen shfrytëzuesit e objekteve komunale edhe lokalet afariste të Komunës së Rahovecit që obligimet e mbetura deri me datën 30.10.2020 të kryhen më së largu deri më tani 30.12.2020. për zbatimin e këtij propozimi kujdeset Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm pranë Komunës së Rahovecit. Ftoj anëtarët e Komitetit për Politike dhe Financa të përkrahin këtë pikë.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, gjithashtu e falënderoj drejtorin edhe për këtë pikë edhe jemi që me ju dalë në ndihmë bizneseve dhe jam mbështetje për këtë që sa do pak për 3 muaj të i lirojmë mirëpo desha me ditë arsyen se a është vetëm me ju dal në ndihmë por ka edhe një qellim tjetër sigurisht ndihmon që me i mbledhë borxhet e deritanishme që sigurisht edhe ajo e ka efektin e vet. Pyetja është nëse këta që i kanë këto lokale me qira nuk i kryen obligimet deri me datën 01.12.2020 a do ta gëzojnë këtë të drejtë apo jo për me u lirua për këta 3 muaj.

Fehmi Cena – Drejtori e sqaroi arsyeshmërinë pse po kërkohet që këto biznese apo personat fizik apo juridik të lirohen nga obligimet komunale për periudhën 3 mujore, mendoj se fillimisht po dua një gabim me largua nga këtu në faqen e parë që ndoshta është gabim teknik ku thuhet përfshihet 3 mujori i fundit tetor, nëntor, dhjetor. Në pikën 1 gjithçka është në rregull 01.10.2020 deri me 31.12.2020 mirëpo në pikën 3 thuhet obligohen shfrytëzuesit e objekteve komunale dhe lokaleve afariste të komunës së Rahovecit që obligimet e mbetura deri me 30.10.2020 dhe duhet me qenë deri 30.09.2020 pasi muaji i dhjetë hynë në kuadër të lirit. Kështu që po mendoj që për mbledhjen e ardhshme drejtoria me na dhanë të dhënat sa me te sakta se sa është numri i këtyre lokaleve afariste komunale që mendohet të lirohen nga obligimet edhe sa është shuma e përgjithshme që do të falen sepse duhet me ditë ne raport me planifikimin që e ka bërë komuna sa do të jetë minus që do të jetë i planifikuar. Natyrisht me atë vigjilencën që megjithatë duhet të gjenden forma të tjera të hyrat të arkëtohen që planifikimi të jetë i realizuar ashtu sikurse e keni bërë.

Artan Asllani – Rreth pyetjes së parashtruar nga kuvendari Fehmi Cena, bëhet fjala për 30 lokale afariste komunale dhe propozimi është deri me datën 01.10.2020. Po ashtu ne kemi planifikua disa biznese kryesisht kontratat janë të reja që janë lidhur në këtë vite dhe po ashtu janë edhe 10 operatorë tjerë që kanë pasur edhe me herët kontrata. Me këtë kemi deshtë me bo që ata që kanë mbetur ne obligime që me pas mundësi me i shlye obligimet që kanë mbetur dhe bëhet fjalë për 18,000 edhe për herë të parë do të dalim mirë me auditorët që faktikisht edhe ne po i ndihmojmë ata edhe ata që kanë obligime duhet ta kenë parasysh se duhet patjetër me i pagua. Atëherë nëse nuk i paguajnë ashtu siç është në propozim atëherë e humbin të drejtën nga ky lirim

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatojmë se kalon për kuvend edhe pika e tetë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Informatë nga DKA-ja për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021.

Avni Morina – Përshëndetje kryesues dhe gjithë ju të pranishëm. Kam përgatitur një informatë me shkrim për përgatitjet që i kemi bërë rreth fillimit të vitit të ri shkollor 2020/2021.

Drejtoria Komunale e Arsimit ka punuar dhe ka bërë të gjitha përgatitjet e duhura për një fillim të mbarë të vitit të ri shkollor 2020/2021. Në fillim të muajit gusht, kemi analizuar me kujdesin më të madh gjendjen e personelit mësimor në të gjitha shkollat e komunës sonë, duke bërë një planifikim dhe një ri sistemim të kuadrit mësimor sipas profileve mësimore në të gjitha nivelet, duke filluar nga niveli parafillor e deri tek niveli i mesëm i lartë.

Si rezultat i planifikimit të bërë, kemi patur edhe konkurse për plotësimin e vendeve të lira në disa pozicione në shkollat e komunës, shumica e të cilave ishin zëvendësime, pra pozita me kohë të caktuar. Drejtoria Komunale e Arsimit ka marrë të gjitha masat që procedura e konkurseve të shkojë mirë, duke respektuar të gjitha afatet ligjore dhe udhëzimet administrative të MASH-it, kështu që, konkursat u hapën dhe u zhvilluan në përputhje të plotë me Udhëzimin Administrativ 10/2018.

Në fund të muajit gusht, nga Ministria e Arsimit kemi pranuar të gjitha librat/tekstet shkollore për klasat 1 deri 9, të cilat fillimisht i kemi vendosur në pikën grumbulluese dhe pastaj ato i kemi shpërndarë në të gjitha shkollat fillore të komunës sonë. Fillimi i Vitit të Ri Shkollor si në mbarë Kosovën, edhe tek ne ishte më 14

shtator, dhe që në fillim, të gjitha SHFMU-të e komunës sonë ishin të pajisura me tekste shkollore. Ky vit shkollor filloi me vonesë për shkak të pandemisë globale COVID-19. Para se të fillojë viti shkollor është themeluar Task Forca Komunale në nivel të DKA-së dhe gjithashtu janë themeluar Task Forcat e Shkollave, të cilat kanë vepruar në përputhje me Udhëzuesin e Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për të zhvilluar procesin mësimor në kushte e rrethana pandemie. Është bërë dezinfektimi i shkollave dhe pajisa e tyre me maska, dezinfektues dhe mjete higjienike. Mësimi në javën e parë filloi pjesërisht, duke filluar me klasat 0,1,2,3, 6 dhe 10 në shkollat me numër të madh të nxënësve, ndërsa në shkollat me numër të vogël të nxënësve mësimi filloi me të gjitha klasat.

Në javën e dytë, pra më 21 shtator 2020, mësimi filloi me të gjitha klasat sipas skenarit A me prezencë në shkollë, por klasat me numër të madh të nxënësve u ndanë në grupe dhe nëpër shkolla u koordinua orari, duke u përshtatur me numrin e nxënësve dhe me hapësirat shkollore.

DKA ka grumbulluar të gjitha kërkesat e shkollave për lëndë djegëse që do të përdoren për ngrohje gjatë muajve të dimrit, dhe furnizimi është bërë në shumicën e shkollave, përveç 4 shkolla, të cilat do të furnizohen shumë shpejtë. Kemi filluar dhe përfunduar realizimin i projektit të instalimit të ngrohjes qendrore edhe në 2 shkolla të komunës, në SHFMU „Dëshmorët e Lirisë“ në Pataqan të Poshtëm dhe në SHFMU „Vëllezërit Frashëri“ në paralelen e ndarë në Senoc, ndërkohë që ka përfunduar zbatimin i projektit i efikasitetit të energjisë në SHFMU „Nesimi Elshani“ në Nagavc. Kemi nënshkruar marrëveshje me MZHE që të do të nisin procedurat për realizimin e projektit të efikasitetit të energjisë edhe në 3 shkolla, në SHML „12 Maji“ në Ratkoc, në Shfmu „Skender Kasstrati“ në paralelen në Gexhë dhe në Shfmu „Hamëz Thaçi“ në Xërxë. Ka vazhduar ndërtimi i objekteve shkollore në Hoçë të Vogël/Brestoc, në Retijë, në Fortesë, Kaznik dhe ka vazhduar ndërtimi i çerdheve në Ratkoc, Krushë të Madhe dhe Xërxë. Dy shkolla të komunës sonë kanë vazhduar zbatimin e projekteve të fituara nga Banka Botërore, në kuadër të të cilave janë bërë disa furnizime me pajisje laboratorike dhe mjete konkretizimi.

Me keqardhje duhet t'ju themi se trendi i rënies së numrit të nxënësve edhe këtë vit është shumë i madh dhe numri i nxënësve në komunën tonë është 9576. Zvogëlimi i numrit të nxënësve ka shkaktuar probleme sepse ka ndikuar edhe në zvogëlimin e numrit të klasave dhe për pasojë edhe zvogëlimin e normave të mësimdhënësve.

Ne kemi qenë dhe jemi vazhdimisht në kontakt të përhershëm dhe në vizita në shkolla dhe sipas të gjitha të dhënave që kemi, procesi mësimor po zhvillohet sipas planifikimeve të bëra nga Task Forca Komunale dhe nga Task Forcat e Shkollave.

Drejtoria Komunale e Arsimit ka bërë gati një plan me një varg aktiviteteve dhe fillimisht kemi filluar vizitat e zyrtarëve të DKA-së në të gjitha shkollat. Vizita të këtilla nëpër shkolla do të ketë vazhdimisht sepse synojmë që sistemin arsimor të komunës sonë ta ngrisim në një nivel më të lartë, që siguron arsim cilësor.

Kjo informatë është bërë me datën 09.10.2020 dhe ndërkohë brenda kësaj periudhe deshta të ju informoj se është lidhur edhe një kontratë me kompaninë e cila do të kujdeset për mirëmbajtjen dhe dezinfektimin e shkollave. Pra dezinfektimi i shkollave është bërë gjatë këtij vikendi dhe të gjitha objektet e shkollave janë dezinfektuar pra të shtunen dhe të dielën dhe ditën e ejte do vinë të gjitha paisjet higjienike si dezinfektues sipas kontratës që kemi lidhur me MSS kompaninë dhe do të grumbullohen fillimisht në deponi të komunës e pastaj do të ju shpërndahen shkollave. Deri me tash të gjitha kontributet që janë dhënë për dezinfektim të shkollave për ndërmarrjen e masave mbrojtëse janë bërë nga komuna jonë pasi nuk kemi pasur kontratë deri me tash qoftë me dezinfektues apo me maska, që gjithashtu kemi pasur edhe donatorë si UNICEF, USAID që na kanë dhuruar maska termometër për matjen e temperaturës dhe ju kemi shpërndarë të gjitha shkollave, pastaj kemi pasur edhe donatorë nga njerzë të vullnetit të mirë si nga bashkatdhetarët e kështu me radhë. Pra keto janë të gjitha zhvillimet që kanë të bëjnë me fillimin e vitit të ri shkollor.

Fahrie Lushi – E falenderojmë drejtorin për këtë informatë nga DKA-ja. Unë thjesht e kam një pyetje për drejtorin se a ka filluar ngrohja qendrore nëpër shkolla e cila fillon me 15 tetor, pasi e di që në Prishtinë fillon nga 15 tetori dhe ashtu është e rregulluar, thjesht kjo më intereson edhe është procedurë pasi edhe këtu në kuvend e kemi pak më ftohtë edhe sigurisht që është ajo që do të nderlidhesha me këtë pasi në fillim të muajit gusht e ka përmendur lidhja e këtyre kontratave apo zëvendësimin e këtyre kontratave ose

zëvendësimi i këtij personeli. Dhe dua të di se çka nënkupton kjo se kush është zëvendësuar pasi po thotë se kemi analizuar kujdesin më të madhë në gjendjen e personelit mësimor. Tash dua të di se cila kategori që është zëvendësuar dhe cilën kategori të mësimdhënësve e kanë zëvendësuar me staf të ri, pasi e kuptova shumë mirë se janë kontrata me zëvendësim në afat të caktuar mirëpo në cilën kategori të mësimdhënësve e keni zëvendësuar në shkollat tona.

Florida Bajraktari – E falenderoj drejtorin për këtë informatë, nuk kisha diçka tjetër për të thënë por vetëm një lëshim është bërë këtu ku thuhet ka vazhduar ndërtimi i çerdhes në Ratkoc, Krushë të Madhe dhe prapë thuhet Krushë të Madhe e që duhet me u ndrrue për mbledhje të Kuvendit edhe me u bë Xërxë. Poashtu edhe një pyetje për drejtorin se a i kanë informuar nxënësit nëpër shkolla që janë të liruar nxënësit prej moshës 5-10 vjet që nuk janë të detyruar me mbajt maska pasi vazhdojnë me i mbajt maskat keshtu që duhet me i njoftue që me i lirue.

Dervish Çadraku – E falenderoj drejtorin për informatën që na ka dhënë, unë kisha dy shqetësime por njeri si duket u largua tani kur pata parasysh për informatën që i kemi marr të gjitha masat për sigurimin e dezinfektuesve nga Covid. Dhe pyetja e tjetër do ishte se çfarë keni bërë me printer sepse gjithë vitin shkollat po kanë problem me printer saqe kaniher printerët po janë me të vlefshëm se sa drejtorët që i kemi aty.

Avni Morina – Faleminderit për kontributin tuaj me pyetjet e parashtruara. Fillimisht me pyetjen e asambleistes Fahrie Lushi, ngrohja qendrore zyrtarisht fillon me 15 nëntor nëpër shkolla por kjo nuk do të thott që ka datë fikse varesisht nga kushtet e motit që mund të fillojë edhe më heret. E rëndësishme se shkollat janë të përgaditura sepse lëndet djegëse janë siguruar dhe sipas informacioneve të fundit vetem edhe dy shkolla kanë mbetur pa u furnizuar me lëndë djegëse pasi pak ka pasur edhe neglizhencë nga furnitori por sigurisht që do t'i kryej brenda këtij muaji. Në pyetjen tjetër se kush është zëvendësuar me staf të ri, tani para hapjes se çdo konkursi, ne i marrim kërkesat prej shkollave d.m.th. ne e kemi përfunduar një vit mësimor 2019/2020 dhe kemi qenë para fillimit të vitit të ri shkollor 2020/2021 dhe kur e kam cekur aty se shumica kanë qenë zëvendësime nga rastet e përgjithshme sepse nuk kam shkuar për rastet individuale por ato zëvendësime janë bërë në rastet kur ka pasur pushime lehonie pushime mjeksore dhe normalisht bëhen me kontrata të perkohshme, ndersa kur ka raste kur dikush del në pension dhe ka fond të orëve të mjaftueshme për me marr një punëtor të ri atëherë ne hapim konkurs për mësimdhënës të rregullt pa zëvendësim. Pra çdo konkurs kur hapet theksohet në pikat e konkursit në cilat shkolla hapet konkursi, për çfarë mësimdhënës bëhet fjalë, çfar mësimdhënësi kerkohet, a kerkohet me kohë të caktuar apo pacaktuar dhe zakonisht kur janë pushimet e lehonisë shkruhet aty me kohë të caktuar deri sa të kthehet mësimdhënësja nga pushimi i lehonisë, por kështu kanë qenë por shumica kanë qenë zëvendësime dhe shumë raste të rralla kanë qenë për plotësim norme. Pastaj pyetja e parashtruar nga Florida Bajraktari për bartjen e maskave për fëmijet, te gabimi që thatë me herët për Xërxë edhe gjatë leximit e kuptova sepse dy her e kam përmendur Ratkocin mirëpo në vemendje e kam pasur me shkrua Xërxë, keshtu që është fakt që po ndodh ndërtimi i çerdheve në Krsuhë të Madhe, Xërxë dhe Ratkoc, nga ecuria e ndërtimit më përpara është çerdhja në Ratkoc nga dinamika e punimeve pastaj është Xërxja dhe në Krushë gjithashtu tani është duke u bërë kulmi i ndërtesës së çerdhes. Te bartja e maskave te fëmijët, fillimisht kur me ka ardh njoftimi kam pasur dilemat e mia për fëmijët deri në moshën 12 vjeçare mirëpo kur e kam marr udhëzuesin edhe e kam lexuar që na ka ardhë nga Ministria e Shëndetësisë e që e ka pranuar Ministria e Arsimit e kam verejtur që fëmijët megjithatë duhet t'i bartin maskat kur janë në shkollë deri në 12 vjeç dhe ata nuk obligohen me i bartë maskat kur dalin në ambientet e hapura kurse në ambientet e mbyllura duhet me i bartë maskat dhe aty theksohet se ky udhëzim ka ardhë nga Ministria e Shëndetësisë dhe pastaj ne e kemi zbatuar pasi kam pasur këtë dilemë edhe nga mësimdhënësit dhe drejtorëve të shkollave dhe ata menjëherë e kanë kuptuar se duhet me ju heq maskat deri në 12 vjeç mirëpo pastaj ju kam sqarue sepse ju kam dergue udhëzimin të gjithë drejtorëve edhe jemi sqaruar rreth kësaj. Pyetja e parashtruar nga Dervish Çadraku, për çështjen e printerëve problemi po zgjidhet më në fund pasi vertet edhe ne këtu në institucionin e komunës kemi pasur problem, siç e dini ajo kontratë ishte e lidhur nga niveli qendror edhe ata kanë shumeëngadalë deri sa kanë fillue me zbatue dhe vazhdimisht ju kemi bërë presion, bile në mbledhjen e fundit e kuvendit të komunës ka qenë një kërkesë edhe prej kuvendarëve poashtu pas mbledhjes prapë e kemi angazhuar stafin e IT-së dhe kemi derguar kërkesa shitesë që me ndodhë furnizime dhe besoj brenda ketyre dy javëve do të furnizohen të gjitha shkollat.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, të nderuar kolegë, me që nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatojmë se kalon për Kuvend edhe pika e nëntë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dhjetë të rendit të ndryshme:

10. Të ndryshme.

Ateherë meqë nuk kemi askend për këtë pikë, unë ju falenderoj të gjithëve për kontributin e dhënë. Shihemi në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoj 12:30

Procesmbajtësi,

Agim Hoti

